



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:230734

Datë: 19.06.2024

Numri i dokumentit: 05833677

KPPP.nr. 1727/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Medruplast Sh.P.K., me numër unik identifikues 812041119 dhe seli në Obiliq, Llazarevë, Zona Industriale, kundër debitorit A.B. B.I. – N.T. “A&N”, me numër unik identifikues 81059137 dhe seli në Prizren, Korishë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Durim Nevzati, avokat nga Prizreni, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 568/23, i lejuar me datë 28.09.2023, nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 19.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pasafatshëm prapësimi i debitorit A.B. B.I. – N.T. “A&N”, i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 568/23, i lejuar me datë 28.09.2023 nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Medruplast Sh.P.K., me datë 28.09.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 568/23, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 19-SHV01-002-3680, e datës 19.08.2019; Faturës nr. 19-SHV01-002-4137, e datës 02.09.2019; Faturës nr. 19-SHV01-002-4301, e datës 16.09.2019; Faturës nr. 19-SHV01-4669, e datës 07.10.2019; Faturës nr. 19-SHV01-002-4761, e datës 21.10.2019; Faturës nr. 19-SHV01-002-5108, e datës 04.11.2019; Faturës nr. 19-SHV01-002-5206, e datës 25.11.2019; Faturës nr. 20-SHV01-002-1635, e datës 13.04.2020; Faturës nr. 20-SHV01-002-2030, e datës 18.05.2020, me të cilin është urdhëruar debitori që t’ia paguajë kreditorit shumën e borxhit sipas faturave të lartcekura në lartësi prej EUR 1,515.29 (njëmijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë euro e njëzet e

nëntë cent), me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër këtij urdhri, debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 10.10.2023, ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor me arsyetim se dokumentet e besueshme mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor kanë arritur afatin e parashkrimit sipas dispozitave të nenit 355, lidhur me nenin 341, par. 3 të LMD-së, e pasi që propozimi për përmbarim është parashtruar me datë 28.09.2023, kanë kaluar më shumë se 3 vite. Ka shtuar se në dokumentet e besueshme të bashkangjitura në propozimin për përmbarim nuk vërehet afati i kërkueshmërisë së detyrimit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbarim të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit janë të pa bazuara dhe nuk kanë mbështetje ligjore, pasi që faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbarimor i përmbajnë të gjitha tiparet e përmbarueshmërisë. Ka shtuar se faturat janë të nënshkuara dhe të vulosura nga debitori, ku kreditori ka lëshuar faturën në momentin e shitjes së mallit, ndërsa malli është pranuar nga debitori në sasinë dhe shumën sipas faturës. Duke qenë se prapësimi i debitorit nuk mbështetet në asnjë provë, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm, për arsyet si në vijim:

Nga shkresat e lëndës rezulton se debitori me datë 02.10.2023 e ka pranuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 568/23 të lejuar me datë 28.09.2023 nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj, fakt ky i cili vërtetohet nga fletë-kthesa për dorëzim personal të përmbaruesit privat e cila gjendet në shkresat e lëndës. Ndërsa nga shkresat e lëndës, rezulton se debitori përmes postës rekomande me datë 10.10.2023 ka paraqitur prapësimin ndaj këtij urdhri, fakt ky i cili vërtetohet nga zarfi i postës me numër R 5348726 pjesë e shkresave të lëndës, e të cilën datë e ka evidentuar edhe debitori në prapësim si datë të përpilimit të prapësimimit.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, ndërsa me nenin 126, paragrafi 2 të Ligjit për procedurën kontestimore, përcaktohet se *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të*

cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”

Në mbështetje të dispozitave si më lartë, si dhe nisur nga fakti se debitori urdhrin përmbarimor e ka pranuar me datë 02.10.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 03.10.2023, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 09.10.2023.

Prandaj, meqë debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 10.10.2023, përmes postës rekomande, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, dhe rrjedhimisht prapësimi i debitorit është i pa afatëshëm.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 73, paragrafi 3 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1727/23, datë 19.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.